



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENCIMIT

AN030220230001

Tiranë, më: 20.03.2023

Vendimi 33

DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore negative, për Zhvilluesin me të dhënat si më poshtë:

Personi Juridik: “SHKELQIMI 07” Sh.p.k

Nr. NIPT-i: K68121808W

Adresa e selisë: Fshati Belishov, Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Zona Kadastrale 1143, Numer Pasurie 186/7, Qendër - Mallakastër, Mallakastër, Fier.

Personi përgjegjës: Shkelqim Kapllanaj

Për të zhvilluar projektin “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr.10 440, datë: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Zona Minerare Nr. 421/3, Objekti “Përroi i Thatë Shesa” Ish-Njësia Administrative Kutë, fshati Drizar, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr.10440, date 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Refuzimi i kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, për shkak të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis me pasoja afatgjata, që dëmtojnë cilësinë e mjedisit dhe nuk mundësojnë përmbushjen e standardeve mjedisore përkatëse.

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr.10440, datë: 7.7.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

Drejtoritë teknike të ministries shprehin mendimin si më poshtë vijon: Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Mjedisit shprehet si më poshtë:

- Mendimi i bashkisë Mallakastër është negativ për zhvillimin e këtij aktiviteti, kështu që heqja nga fondi pyjor nuk mund të bëhet.
- Nuk jepet forma e menaxhimit (përdorimit) të sipërfaqes ku do të ushtrohet aktiviteti dhe treguesit kadastralë për pyjet/kullotat;
- Në konsultimin publik duhet që të kishte përfaqësues të strukturës përgjegjëse për pyjet në bashki;
- Lista e pjesëmarrësve është e ndryshme në dy dokumentet që janë paraqitur;
- Duhet patjetër të ketë masa për mbrojtjen nga zjarri në raste aksidentale pasi në raporte shprehet se do përdoren edhe lëndë plasëse, etj.;
- Në çdo rast duhet të mbahet parasysh zbatimi me rigorizitet i nenit 12, të Ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 "Për Pyjet";
- Subjekti t'i përmbahet legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht: Ligjit nr. 9587, datë 20.7.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit" i ndryshuar dhe Ligjit nr.10 006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër" i ndryshuar;
- Të bëjë rehabilitimin e zonës me mbjellje pemësh;
- Subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit t'i përmbahet legjislacionit në fuqi në lidhje me zhurmat.
- *Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit shprehet me rekomandimet si më poshtë vijon: Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:*
 - Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë";
 - Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit";
 - Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit".Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, përdorimi i lëndëve plasëse, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 "Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil".

Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

Lidhur me bazën ligjore të cituar në raportin e VNM-së, shprehemi si më poshtë vijon:

- Ligji i cituar në raport nr.8897/2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja" është shfuqizuar dhe aktualisht është në fuqi ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i cili shoqërohet me disa akte nënligjore të dala në zbatim të tij.
- *Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Mjedisit shprehet si më poshtë vijon:*

- Të zbatohet Ligji nr. 10 463, date 22.09.2011, “Per menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.
- Të respektohen kërkesat e VKM nr. 418, date 25.06.2014, “Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim”.
- Mbetjet që do të krijohen, të specifikohen sipas kodeve të VKM nr. 99, date 18.02.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, të ndryshuar.
- Transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, të ndryshuar.
- Mbetjet e rrezikshme, të dorëzohen sipas VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, të ndryshuar.
- Subjekti që do të transportojë ose do të transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licensë III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve “ i ndryshuar.
- Gjatë fazës ndërtimore mbetjet inerte të gjeneruara të trajtohen sipas kërkesave të VKM nr. 575, datë 24. 06. 2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- Për të gjitha mbetjet nga ambalazhet të zbatohet VKM nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, i ndryshuar.
- Në veprimtarinë për të cilën aplikon subjekti, menaxhimi i mbetjeve të bëhet sipas Parimit të Përgjegjshmërisë Ndaj Mjedisit, në përputhje të plotë me VKM nr. 418, datë 27.5.2020 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020-2035”, duke synuar uljen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara dhe menaxhimin në mënyrë të integruar të mbetjeve.
- Të respektojë Ligjin nr. 68-2014, dt. 03.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit; të ndryshuar”.
- Të respektojë Ligjin nr. 81 dt. 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”;
- Të respektojë Ligjin nr. 10 006, dt. 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”;
- Të respektojë Vendimin nr. 303, dt. 10.5.2019 “Për Miratimin e Listës së Rishikuar, të Përditësuar, të Monumenteve të Natyrës Shqiptare”.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku kërkon të zhvillohet aktiviteti “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror. Zona Minerare nr. 421/3, objekti "Përroi i Thatë shtesa", Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, me zhvillues “SHKËLQIMI 07” dhe aplikues “Vanina Latifi”, me nr. Aplikimi AN030220230001, nuk ndodhet brenda rrjetit të zonave të mbrojtura

Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet:

Mendimi 1 datë 28.02.2023

Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve për dhënien e mendimit për VNM u mbështet në Ligjin 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjit Nr.10 440, date 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi me datë 24.02.2023 në Subjektin: “Shkëlqimi 07” Sh.p.k me Aktivitet: “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit gur gëlqeror”, me Vendndodhje: Zona Minerare Nr. 421/3, Objekti “Përroi i Thatë Shesa”, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.

Shfrytëzimi do të bëhet me punime sipërfaqësore (karrierë) dhe do të bëhet nga lart - poshtë duke filluar nga shkalla e parë + 140m deri në shkallën fundore + 210 m. Minerali ndërtimor “gur gëlqeror” i prodhuar në karrierë do të përdoret për prodhim inertesh, lëndë e parë për industrinë e ndërtimit. Ndikimi më i madh negativ i këtij aktiviteti është ndryshim i peisazhit në një sipërfaqe prej 0.052 km² dhe humbje e strukturës së tokës.

Aktiviteti që zhvillohet mund të shkaktojë rritje të shkallës së erozionit. Pjerrësia e terrenit mund të bëhet shkak që grimcat e tokës të ekspozohen ndaj agentëve atmosferikë duke u shkëputur dhe lëvizur jashtë zonës së shfrytëzimit. Mbetjet që do të krijohen nga aktiviteti i shfrytëzimit të gëlqerorit janë :

- Mbetje që dalin nga kërkimet dhe shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko-kimike të mineraleve
- Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve jometalore.

Sugjerime:

- } Të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve sterile dhe dherave që prodhohen gjatë fazës së zbulimit të mineralit gur gëlqeror duke u sistemuar në sheshin e depozitimit të përcaktuar brenda sipërfaqes që kërkohet leja minerare.
- } Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- } Të evitohet efekti i erozionit.
- } Të bëhet sistemimi i dherave në tarracat e shesheve të shkallëve për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqet për mbjellje, shkurrese ose barishtesh të zonës duke përmirësuar dhe peisazhin estetik.
- } Mbetjet sterile dhe inerte të ripërdoren për rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit dhe për ndërtimin e një sërë rrugësh të brendshme në zonën e karrierës.
- } Subjekti duhet të zbatojë kushtet e VKM 315, dt. 5.5.2010, pika 2, paragrafi “a”;“Për procedurën e dhënies së Autorizimit, për përdorim civil të lëndëve plasëse”.
- } Subjekti duhet të plotësojë parametrat e pashaportave përkatëse të shpim plasjeve.
- } Të mbushen birat nga lëndët plasëse me amonit malor.
- } Të përdoret ujë për lagjen e territorit në formë spërkatje për shmangien e pluhurave dhe këto ujëra së bashku me ujërat e shiut të grumbullohen në vaska dekantimi para se të derdhen në kanalet e zonës.
- } Të monitorohet niveli i zhurmave sipas Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.
- } Të zbatohet legjislacioni mjedisor në fuqi gjatë shfrytëzimit.
- } Territori ku kryhet aktiviteti minerar duhet të rrethohet me tabela paralajmëruese ku të tregohet për punimet që kryhen, rradhën e kryerjes së tyre.
- } Të kryhet rehabilitimi përfundimtar i shkallëve të karrierës, shesheve të karrierës, rrugëve jashtë karriere, shesheve të depozitimit të sterileve etj.

Mendimi 2 datë 13.03.2023

Verifikimi në objekt për inspektimin e subjektit nga specialistët e Lejeve dhe VNM-ve për dhënien e mendimit për VNM u mbështet në Ligjin 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, Ligjit Nr.10 440, date 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Vendimin numër 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” dhe akteve nënligjore mjedisore në fuqi me datë 24.02.2023 në Subjektin: “Shkëlqimi 07” Sh.p.k me Aktivitet: “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit gur gëlqeror”, me Vendndodhje: Zona Minerare Nr. 421/3, Objekti “Përroi i Thatë Shesa”, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.

Shfrytëzimi do të bëhet me punime sipërfaqësore (karrierë) dhe do të bëhet nga lart - poshtë duke filluar nga shkalla e parë + 140m deri në shkallën fundore + 210 m. Minerali ndërtimor “gur gëlqeror” i prodhuar në karrierë do të përdoret për prodhim inertesh, lëndë e parë për industrinë e ndërtimit. Ndikimi më i madh negativ i këtij aktiviteti është ndryshim i peisazhit në një sipërfaqe prej 0.052 km² dhe humbje e strukturës së tokës.

Aktiviteti që zhvillohet mund të shkaktojë rritje të shkallës së erozionit. Pjerrësia e terrenit mund të bëhet shkak që grimcat e tokës të ekspozohen ndaj agentëve atmosferikë duke u shkëputur dhe lëvizur jashtë zonës së shfrytëzimit. Mbetjet që do të krijohen nga aktiviteti i shfrytëzimit të gëlqerorit janë :

- Mbetje që dalin nga kërkimet dhe shfrytëzimi i minierave dhe karrierave, si edhe nga trajtimet fiziko-kimike të mineraleve
- Mbetje që dalin nga nxjerrja e mineraleve jometalore.

Sugjerime:

- } Të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve sterile dhe dherave që prodhohen gjatë fazës së zbulimit të mineralit gur gëlqeror duke u sistemuar në sheshin e depozitimit të përcaktuar brenda sipërfaqes që kërkohet leja minerare.
- } Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- } Të evitohet efekti i erozionit.
- } Të bëhet sistemimi i dherave në tarracat e shesheve të shkallëve për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqet për mbjellje, shkurrese ose barishtë të zonës duke përmirësuar dhe peisazhin estetik.
- } Mbetjet sterile dhe inerte të ripërdoren për rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit dhe për ndërtimin e një sërë rrugësh të brendshme në zonën e karrierës.
- } Subjekti duhet të zbatojë kushtet e VKM 315, dt. 5.5.2010, pika 2, paragrafi “a”;“Për procedurën e dhënies së Autorizimit, për përdorim civil të lëndëve plasëse”.
- } Subjekti duhet të plotësojë parametrat e pashaportave përkatëse të shpim plasjeve.
- } Të mbushen birat nga lëndët plasëse me amonit malor.
- } Të përdoret ujë për lagjen e territorit në formë spërkatje për shmangien e pluhurave dhe këto ujëra së bashku me ujërat e shiut të grumbullohen në vaska dekantimi para se të derdhen në kanalet e zonës.
- } Të monitorohet niveli i zhurmave sipas Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara”.
- } Të zbatohet legjislacioni mjedisor në fuqi gjatë shfrytëzimit.
- } Territori ku kryhet aktiviteti minerar duhet të rrethohet me tabela paralajmëruese ku të tregohet për punimet që kryhen, rradhën e kryerjes së tyre.
- } Të kryhet rehabilitimi përfundimtar i shkallëve të karrierës, shesheve të karrierës, rrugëve jashtë karriere, shesheve të depozitimit të sterileve etj.

Bashkia Mallakastër shprehet:

Mendimi 1 datë 24.02.2023

Mbështetur në Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” , në zbatim të VKM nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt në tjetrin, të kushteve për lejet respektive

të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

Sipas zonalitetit vertikal, zona e projektit "Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror" është tokë natyrore. Sipas nenit 82 të rregullores së zhvillimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Mallakastër miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 7 datë 14.10.2020. Neni 82 parametrat e lejuara për strukturat që lejohen në kategorinë tëke natyrore.

Pika 5 -Përdorime të ndaluara: Kategoritë e sistemit Urban: A – Banim, Industri, Ekonomi – çdo rast i ndryshëm nga pika 4 e këtij neni, IS (nënkategoritë e ndryshme nga IS2). Kategoritë e sistemit bujqësor: Ekonomi bujqësorë (vetëm nënkategoria e EB3), BA – Bujqësi banim.

Bashkia Mallakastër jep mendim negativ për aktivitetin "Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror", zona Minerare Nr. 421/3, Objekti "Përroi i Thatë Shesa" ish-njësia administrative Kutë, fshati Drizar, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, të shoqërisë "Shkëlqimi 07" sh.p.k.

Mendimi 2 datë 15.03.2023

Mbështetur në Ligji nr. 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajërimit nga ndotja", Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, Ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i ndryshuar, Vendimit Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" , në zbatim të VKM nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt në tjetrin, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

Sipas zonalitetit vertikal, zona e projektit "Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror" është tokë natyrore.

Sipas nenit 82 të rregullores së zhvillimit të planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Mallakastër miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 7 datë 14.10.2020.

Neni 82 parametrat e lejuara për strukturat që lejohen në kategorinë tëke natyrore.

Neni 82 parametrat e lejuara për strukturat që lejohen në kategorinë tëke natyrore.

Pika 4. Përdorimet e lejuara:

Nënkategoritë NAR3 – shtigje dhe NAR4 - Ekoturizëm (sipas nenit 86, lartësia sipas pikës 11 të këtij neni).

Të gjitha kategoritë e sistemit natyror dhe ujore. Kategoritë e sistemit bujqësorë: B - toke bujqësore, IB – infrastrukture bujqësore, EB – ekonomi bujqësore (vetëm nënkategoritë e EB1, EB2).

Të gjitha kategoritë e sistemit infrastrukture, të shqyrtuara rast pas rasti në varësi të shkallës së ndotjes dhe pajisjes me leje mjedisore përkatëse, si dhe respektimit të brezave mbrojtës nga monumentet e natyrës, sistemi ujore apo monumentet e natyrës.

Kategoritë e sistemit urban: S – Shërbimet, IS – Institucione (vetëm nënkategoria IS2), AS – Arsim, SH – Shëndetësi, SHA – Aktivitete Shoqërore dhe Argëtimi.

IE – Industri Ekonomike – sipas rekomandimeve dhe vetëm në territoret e përfshira në:

PKS "Plani i integruar sektorial për zhvillim dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Ballsh – Hekal, Cakran – Mollaj, Gorisht – Kocul dhe Delvin" – miratuar me vendim të KKT-së nr.3, datë 04.07.2013.

PKS: “ Plani i integruar sektorial për zhvillimin e prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Patos – Marinez” – miratuar me vendim të KKT-së nr.28, datë 10.05.2013. (vendburimi i Visokës).

Pika 5 -Përdorime të ndaluara:

Kategoritë e sistemit Urban: A – Banim, Industri, Ekonomi – çdo rast i ndryshëm nga pika 4 e këtij neni, IS (nënkategoritë e ndryshme nga IS2). Kategoritë e sistemit bujqësor: Ekonomi bujqësore (vetëm nënkategoria e EB3), BA – Bujqësi banim.

Bashkia Mallakastër jep mendim negativ për aktivitetin “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror”, zona Minerare Nr. 421/3, Objekti “Përroi i Thatë Shesa” ish-njësia administrative Kutë, fshati Drizar, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier, të shoqërisë “Shkëlqimi 07” sh.p.k

2. Ministria ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse, si dhe shkallën e reflektimit të tyre;

3. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Agjencia Rajonale e Mjedisit. Eksperti i cili ka firmosur Raportin e VNM-së, ka firmosur formularin e konsultimit me publikun në zbatim të Vendimit nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”; Proçedura e ndjekur, për konsultimin publik është konform Vendimit të Këshillit të Ministrave të sipërcituar.

4. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

Agjencia Kombëtare e Mjedisit mori në shqyrtim aplikimin e subjektit Shkëlqimi 07 Sh.p.k, i është kërkuar dy herë mendimi Bashkisë Mallakastër pas plotësimit të informacionit shtesë të kërkuar në Komisionin Nr.26,

Bashkia Mallakastër shprehet: Mbështetur në Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajërit nga ndotja”, Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” , në zbatim të VKM nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt në tjetrin, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja".

Sipas zonalitetit vertikal, zona e projektit “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror” është tokë natyrore.

Sipas nenit 82 të Rregullores së Zhvillimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 7 datë 14.10.2020.

Neni 82- parametrat e lejuara për strukturat që lejohen në kategorinë tokë natyrore.

Bashkia Mallakastër jep mendim negativ për aktivitetin “Shfrytëzim dhe përpunim i mineralit Gur Gëlqeror”, Zona Minerare Nr. 421/3, Objekti “Përroi i Thatë Shesa” Ish-Njësia Administrative Kutë, fshati Drizar, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.

Përsa më sipër bazuar në mendimin e Bashkisë Mallakastër, AKM shprehet kundër sipas nenit 82 të Rregullores së Zhvillimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Mallakastër miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.7 datë 14.10.2020, zonalitetit vertikal, zona e projektit është tokë natyrore, projekti bie në kundërshtim me PDV-në e Bashkisë Mallakastër.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI

Konceptoi:

Konfirmoi:

Pranoi:

1. Anex 1.Harta dhe koordinatat.

Harta Topografike

